

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT

EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligj “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike”
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Konsultim
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Jo e zbatueshme
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	Strategjia ndërsektoriale për mbrojtjen e konsumatorëve dhe mbikëqyrjen e tregut 2014-2020, e cila është miratuar me VKM nr. 753, datë 16.9.2015
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	Nuk është zhvilluar ende konsultimi publik
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	17.09.2018
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	[2018 – MIE – nr. 2]
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Arben Dhima, Drejtori i Derregullimit, Lejeve, Licencave dhe Monitorimit. arben.dhima@infrastruktura.gov.al Nr tel: 0697973595

PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (Maksimumi 2 faqe)

PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT

Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Pse është e nevojshme ndërhyrja qeverisë?

Problemi në shqyrtim është se Ligji në fuqi nr. 8734, datë 01.02.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike”, megjithë ndryshimet e pësuar ndër vite, nuk i përshtatet më nevojave të stadi aktual, lidhur me sigurinë e punës së pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike, duke patur parasysh edhe zhvillimet teknike dhe teknologjike të ndodhura prej kësaj kohe.

Shkaqet kryesore kanë të bëjnë me faktin se, ligji ekzistues cituar më lart (hartuar në vitin 2001) nuk parashikon detyrat dhe përgjegjësitë e operatorëve ekonomikë që përdorin, mirëmbajnë dhe/ose projektojnë pajisje, impiante e instalime elektrike, nuk parashikon kryerjen e vlerësimit të konformitetit të tyre nga “palë të treta”, Organizma të Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK), në fushën e pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike.

Megjithatë, ky ligj nuk është zbatuar në praktikë, sepse aktet nënligjore që duhej të miratoheshin për zbatimin e këtij ligji nuk janë miratuar dhe, për pasojë, objektivat e përcaktuara nuk kanë qenë të arritshme.

Për këto arsye, në vend të amendimit të ligjit ekzistues, është gjykuar hartimi i projektligjit të ri “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike”, me anë të të cilit do të eliminohen problemet e mësipërme.

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimit?

- Të garantohet rritja e efektivitetit të mbikëqyrjes dhe inspektimit të pajisjeve e instalimeve elektrike, nga ana e Inspektoriatit Shtetëror përgjegjës për to.

- Të garantohet vlerësimi i duhur i konformitetit të pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike nga ana e OMVK-ve.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

Për arritjen e objektivave të politikës në fjalë, janë shqyrtuar tri opsione:

- **“Opsioni 0”** – Ruajtja e “status quo”-së (duke mosndërhyrë me amendime të mëtejshme, në ligjin ekzistues dhe duke mos hartuar një projektligji të ri).
- **“Opsioni 1”** – Amendimi (ndryshimi) i ligjit ekzistues (nr. 8734 të ndryshuar me Nr. 8962, datë 24.10.2002; Nr. 9595, datë 27.7.2006; Nr.10489, datë 15.12.2011, Nr. 65/2012 dhe Nr. 13/2013).
- **“Opsioni 2”** - Miratimi i projektligjit, “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike”, të propozuar.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.

“Opsioni 0” nuk ka avantazhe, në krahasim me opsionet e tjera.

Ligji ekzistues nr. 8734, trajton:

- Krejt përciptas: Kërkesat e sigurisë, vendosjen në treg/në shfrytëzim, mbikëqyrjen dhe heqjen nga tregu,
- Përciptas: Përdorimin e pajisjeve elektrike, këqyrjen e avarisë, statusin e inspektoratit, detyrat dhe të drejtat e inspektoratit,
- Detyrimet e punëdhënësit dhe punëmarrësve, informimin dhe formimin e punëmarrësve që në thelb janë kërkesa për Inspektoratin e punës.

Përmbajtja e këtij ligji, pavarësisht ndryshimeve të bëra ndër vite, nuk garanton më sigurinë e jetës së njerëzve, kafshëve dhe pronës, ndaj vetë përmbajtja e tij është dizavantazh, prandaj këtë opsion e konsiderojmë të papërshtatshëm.

“Opsioni 1”, përbën avantazh në krahasim me Opsionin 0, pasi nëpërmjet amendimit mund të rregullohen një pjesë e problematikave, nga ana tjetër meqenëse nëpërmjet ndryshimeve të mëparshme të cituara më lart, është ndryshuar mbi 50% e përmbajtjes fillestare të ligjit, ndryshimi (amendimi) i mëtejshëm i tij do të vështirësonte përdorimin me efikasitet të vetë ligjit në fjalë, gjë e cila përbën përveç të tjerash një disavantazh, ndaj edhe këtë opsion e konsiderojmë të papërshtatshëm, krahasuar me Opsionin 2.

“Opsioni 2”, është Opsioni i preferuar dhe ka avantazhet e mëposhtme:

- Rrit më tej shkallën e sigurisë së pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike.
- Sanksionon kërkesa të detajuara ligjore, lidhur me projektimin e pajisjeve, impianteve, dhe instalimeve elektrike.
- Sanksionon kërkesa të detajuara ligjore, lidhur me montimin (instalimin) e pajisjeve, impianteve, dhe instalimeve elektrike.
- Sanksionon kërkesa ligjore, lidhur me plotësimin e Deklaratave përkatëse, lidhur me konformitetin dhe përputhshmërinë në pajisjet, impiantet dhe instalimet elektrike.
- Sanksionon kërkesa të detajuara ligjore, lidhur me regjistrimin e pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike.
- Sanksionon kërkesa të detajuara ligjore, lidhur me përgjegjësitë e operatorëve ekonomikë që kanë në pronësi dhe/ose përdorim pajisje, impiante, instalime elektrike, përgjegjësitë për mirëmbajtjen dhe rikonstruksionin e pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike.
- Sanksionon kërkesa të detajuara ligjore, lidhur me këqyrjen e aksidenteve dhe avarive të rënda që mund të ndodhin në pajisjet, impiantet, instalimet elektrike.

- Sanksionon kërkesa të detajuara, ligjore lidhur me mbikëqyrjen dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike, detyrat dhe të drejtat e inspektoriatit shtetëror përgjegjës për pajisjet, impiantet, instalimet elektrike.
- Rikoncepton kundërvajtjet administrative dhe dënimet për shkelje specifike të ligjit.
- Jep nje pasqyrë të plotë, të termave të përdorur në cilësinë e “përkufizimeve”.

Implementimi i tij nuk ka kosto shtesë ekonomike për sektorin publik, por do të ketë impakte sociale, pasi do të rritet shkalla e sigurisë së punës së pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike, duke garantuar sigurinë e jetës së njerëzve, mjedisit etj.

përcaktimi i parimeve të përgjithshme që rregullojnë

Referuar edhe statusit të ligjit, për garantimin e sigurisë së njerëzve, të kafshëve shtëpiake ose të vlerave materiale nga rreziku elektrik.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.

Opsioni i rekomanduar/i preferuar është **Opsioni 2**, i cili do të sigurojë një bazë të re ligjore, që do të mundësojë realizimin e rolit rregullator të shtetit, në fushën e sigurisë së pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike.

Avantazhet e këtij opsioni janë si më poshtë:

- Rrit më tej shkallën e sigurisë së pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike.
- Sanksionon kërkesa të detajuara ligjore, lidhur me projektimin e pajisjeve, impianteve, dhe instalimeve elektrike.
- Sanksionon kërkesa të detajuara ligjore, lidhur me montimin (instalimin) e pajisjeve, impianteve, dhe instalimeve elektrike.
- Sanksionon kërkesa ligjore lidhur me plotësimin e Deklaratave përkatëse, lidhur me konformitetin dhe përputhshmërinë në pajisjet, impiantet dhe instalimet elektrike.
- Sanksionon kërkesa të detajuara ligjore, lidhur me regjistrimin e pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike.
- Sanksionon kërkesa të detajuara ligjore, lidhur me përgjegjësitë e operatorëve ekonomikë që kanë në pronësi dhe/ose përdorim pajisje, impiante, instalime elektrike, përgjegjësitë për mirëmbajtjen dhe rikonstrukcionin e pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike.
- Sanksionon kërkesa të detajuara ligjore, lidhur me këqyrjen e aksidenteve dhe avarive të rënda që mund të ndodhin në pajisjet, impiantet, instalimet elektrike.
- Sanksionon kërkesa të detajuara, ligjore lidhur me mbikëqyrjen dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike, detyrat dhe të drejtat e inspektoriatit shtetëror përgjegjës për pajisjet, impiantet, instalimet elektrike.
- Rikoncepton kundërvajtjet administrative dhe dënimet për shkelje specifike të ligjit.
- Jep nje pasqyrë të plotë të termave të përdorur në cilësinë e “përkufizimeve”.

Në përfundim, konkludojmë se ky projektligj përbën alternativën më të mirë që do të mundësojë garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike.

Kostoja e përlogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):

Viti 1	Viti 2	Viti 3
p.sh. 300 000	p.sh. 300 000	p.sh. 100 000

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar?), çfarë pikëpamjesh janë shprehur, si janë trajtuar ato, domethënë çfarë ndryshimesh janë pranuar dhe çfarë janë refuzuar dhe arsyet pse?)

I. Puna përgatitore për hartimin e projektligjit, “Për garantimin e sigurisë së punës të produkteve, pajisjeve dhe instalimeve elektrike”, nga ana e grupit të punës, ka filluar në vitin 2016 dhe është dërguar për mendim, nga ana e ish MEI-t, shkresërisht në datë 21.12.2016.

Ish MEI ka administruar mendimet e dhëna në përgjigje të shkresës së mësipërme:

1. ERE, me shkresën Nr. 58 Prot. datë 18.01.2017, ka shprehur dakordësinë për projektligjin;
2. ISHTI, me shkresën Nr. 407 Prot. datë 19.01.2017, ka shprehur dakordësinë, me disa vërejtje;
3. KESH, me shkresën Nr. 10108/1 Prot. datë 30.12.2016, ka shprehur dakordësinë, me disa vërejtje;
4. Ish Ministria e Financave, me shkresën Nr. 17694/4 Prot. datë 25.01.2017, ka shprehur dakordësinë, pa vërejtje;
5. Ministria e Drejtësisë, me shkresën Nr. 8367/1 Prot. datë 10.01.2017, ka shprehur dakordësinë, me disa vërejtje;
6. Ish Ministria e Marrdhënieve me Parlamentin, me shkresën Nr. 7427/1 Prot. datë 29.12.2016, ka shprehur dakordësinë, pa vërejtje;
7. Ish Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës me shkresën Nr. 6213/1 Prot. datë 20.01.2017, ka shprehur dakordësinë, pa vërejtje;
8. Ish Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes, me shkresën Nr. 10020/1 Prot. datë 13.02.2017, ka shprehur mosdakordësinë, duke renditur disa vërejtje;
9. OST, me shkresën Nr. 612 Prot. datë 02.02.2017, ka shprehur dakordësinë, me disa vërejtje.

II. Grupi i punës, gjatë vitit 2017 ka ripunuar projektligjin, duke marrë në konsideratë mendimet e administruara si më sipër, dhe me shkresën e MIE-s Nr. 3350 Prot. datë 20.02.2018, ka dërguar projektligjin në:

1. Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë;
2. Ministrinë e Drejtësisë;
3. Në vijim, të sugjerimit të Ministrisë së Drejtësisë, me shkresën Nr. 5412 Prot. datë 21.03.2018, MIE ka dërguar projektligjin për mendim në Inspektoriatin Qëndror.

(MIE, më sipër, ka administruar mendimet e dhëna në përgjigje të shkresës së cituar, në pikën II, duke pranuar një pjesë të sugjerimeve dhe duke refuzuar disa të tjera, por pas konsultimit publik dhe rimarrjes së mendimeve nga institucionet përkatëse, do të reflektohet për sa do të rezultojë.)

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?

Zbatimi i këtij projektligji do të bëhet nga Inspektoriati shtetëror përgjegjës për pajisjet dhe instalimet elektrike, strukturë kjo ekzistuese në përbërje të Inspektoriatit Shtetëror Teknik dhe Industrial, miratuar me VKM Nr. 410, datë 13.5.2015 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoriatit Shtetëror Teknik dhe Industrial”, i cili monitorohet nga struktura administrative përgjegjëse në MIE. OMVK-të mbikëqyren dhe monitorohen gjithashtu nga struktura administrative përgjegjëse në MIE. Për të mundur zbatimin e këtij ligji, do të jetë e nevojshme të hartohet një numër aktesh nënligjore, të cilat do të përcaktojnë detajet, lidhur me zbatimin e tij.

Aktet nënligjore që do të miratohen janë konkretisht, Vendime të Këshillit të Ministrave dhe urdhra të ministrit përgjegjës për energjinë elektrike, që do të përcaktojnë:

1. kategoritë e operatorëve ekonomikë dhe llojet e pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike që i nënshtrohen detyrimit për t’u pajisur me kontratën e sigurimit të përgjegjësisë civile, si dhe kufirin minimal të përgjegjësisë së tyre.
2. rregullat teknike në fushën e pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike.
3. kriteret teknike dhe profesionale që duhet të plotësojnë operatorët ekonomikë projektues të pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike.
4. kërkesat teknike dhe profesionale që duhet të plotësojnë operatorët ekonomikë instalues të pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike.

Historik

Jepni kontekstin e politikës

1. Megjithëse, ligji Nr. 8734 datë 01.02.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike” i ndryshuar, është në fuqi, mbetet i domosdoshëm hartimi i një ligji të ri në funksion të nevojave të kohës, hapjes se tregut dhe poceseve integrale.

2. Propozimi i këtij projektligji, vjen në kuadër të reformimit të sistemit të sigurisë së pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike, me qëllim rritjen e shkallës së sigurisë së punës së tyre, për të garantuar kështu sigurinë e jetës së njerëzve, të kafshëve, mjedisit dhe pronës.

3. Projektligji, përbën një hap kyç përpara i përket përcaktimit të detyrimeve të operatorëve ekonomikë, që kryejnë aktivitete që lidhen me prodhimin, montimin, instalimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike, detyrimet, të drejtat dhe kompetencat e strukturës përgjegjëse (inspektoratit shtetëror përkatës), si dhe trupave inspektuese, palë të treta për inspektimin dhe vlerësimin e konformitetit të tyre, duke përmirësuar kështu kuadrin ligjor dhe institucional.

4. Projektligji nuk ka për qëllim të përafrohet me legjislacionin e Bashkimit Europian. Megjithatë, është pjesë e rëndësishme e programit të qeverisë, vendosja e nivelit më të lartë të sigurisë së pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike, si dhe garantimi i respektimit të kërkesave thelbësore të sigurisë, që duhet të përmbushen nga ana e operatorëve ekonomikë.

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

5. Pavarësisht Ligjit në fuqi nr. 8734, datë 01.02.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike”, të ndryshuar, fusha e sigurisë së pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike përbën ende një fushë të parregulluar në praktikë, duke mos patur një ndarje të qartë të detyrave të inspektoratit shtetëror përgjegjës dhe trupave inspektuese “palë të treta” (Organe të Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit).

6. Përveç punës mjaft voluminoze inspektuese, inspektorati shtetëror përgjegjës lëshon edhe certifikata inspektimi, gjë që nuk mund dhe nuk duhet të kryhet nga ana e tij.

Identifikimi i grupeve të prekura:

- Operatorët ekonomikë që projektojnë, mirëmbajnë dhe përdorin pajisje, impiante dhe instalime elektrike.

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

7. Nëpërmjet ndërhyrjes së qeverisë do të mundësohet:

- Eliminimi i boshllëkut ligjor aktual nëpërmjet miratimit të një ligji të ri dhe shfuqizimit të ligjit ekzistues për sigurinë e punës së pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike.
- Përcaktimi i detyrimeve të operatorëve ekonomikë që projektojnë, mirëmbajnë dhe përdorin pajisje, impiante dhe instalime elektrike.
- Parashikimi i kryerjes së vlerësimit të konformitetit të pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike nga ana e Organizmave të Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK), në përputhje me kërkesat e Krerëve II dhe V të ligjit nr. 10489, datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, të ndryshuar.
- Ndarja e qartë e detyrave të OMVK-ve dhe inspektoratit shtetëror përgjegjës.
- Rritja e shkallës së sigurisë së pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike.

Objektivi i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

8. Qëllimi kryesor i kësaj politike është të garantojë sigurinë e punës së pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike në pronësi, administrim dhe/ose përdorim të operatorëve ekonomikë privatë dhe/ose publikë, nëpërmjet krijimit të një kuadri ligjor dhe përcaktimit të kushteve e kërkesave thelbësore që duhet të përmbushen.

9. Objektivat e saj kryesore janë:

- Realizimi i vlerësimit të konformitetit të pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike nga ana e OMVK-ve.
- Realizimi i inspektimeve periodike të operatorëve ekonomikë publikë dhe/ose privatë që kanë në pronësi dhe/ose përdorim pajisje, impiante, instalime elektrike nga ana e inspektoratit shtetëror përgjegjës.
- Krijimi i një baze të dhënash mbi pajisjet, impiantet, instalimet elektrike në Republikën e Shqipërisë, e cila duhet përdorur për programimin e inspektimeve, kërkesë kjo e ligjit 10433/2011, si dhe për organizimin e vlerësimit të konformitetit prej OMVK-ve, edhe kjo kërkesë e ligjit 10489/2011.
- Aplikimi i dënimeve me gjobë në rastet e shkeljes së rregullave të sigurisë së pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike nga ana e operatorëve ekonomikë.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura.*

Opsioni – status quo

10. Dispozitat e ligjit 8734 nuk rregullojnë gjendjen aktuale të sigurisë së pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike, duke mos parashikuar një ndarje të qartë të detyrave të inspektoratit shtetëror përgjegjës dhe OMVK-ve. Gjithashtu nuk janë miratuar aktet nënligjore për zbatimin e ligjit ekzistues.

11. Në këto kushte, nëse nuk miratojmë një ligj të ri që rregullon situatën aktuale, realizimi i objektivave të lartpërmendura është i pamundur.

Opsioni 1 – Ndryshimi i ligjit ekzistues

12. Pas shqyrtimit të opsionit 2, u vlerësua që ndryshimi i ligjit ekzistues, nuk është alternativa më e mirë për rregullimin e situatës aktuale, pasi do të prekej një numër i madh i dispozitave të ligjit. Sikurse dihet, teknika legjislative nuk lejon ndryshime thelbësore dhe ekzistojnë kufizime që përcaktojnë një përqindje të dhënë të dispozitave që mund të ndryshohen me ligj.

Opsioni 2 (i preferuar) – Miratimi i një ligji të ri, me qëllim garantimin në një shkallë të lartë të sigurisë së pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike.

13. Projektligji do të përbëjë një bazë të re ligjore, që do të mundësojë realizimin e rolit rregullator të shtetit në fushën e sigurisë së pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike.

14. Nëpërmjet këtij opsioni, rivlerësohet fusha e veprimit, ku përveç kërkesave teknike që përfshijnë projektimin, montimin dhe shfrytëzimin e pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike dhe që mbikëqyren nga inspektorati shtetëror përgjegjës, specifikohen më tej edhe kërkesat teknike për trupat inspektuese “palë të treta”, që janë Organizma të Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK), në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10489, datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, të ndryshuar, duke bërë të mundur lehtësimin e punës voluminoze inspektuese të inspektoratit shtetëror përgjegjës, i cili nuk mund dhe nuk duhet ta kryejë atë.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- *Identifikoni se kush preket.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni nga ana sasimore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
 - *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin 1/a për tabelën që mund të përdorni).*
 - *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.*
- *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*
- *Diskutoni kufizimin e analizës:*
 - *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
 - *Tregoni sa të forta, të pavarura dhe të rëndësishme janë provat që mbështesin supozimet.*
 - *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*
- *Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:*
 - *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
 - *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*
 - *Paraqisni përlogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (shih aneksin 1/b për tabelën që mund të përdorni).*

15. Nuk ka ndikim financiar në buxhetin e shtetit, pasi Inspektoriati shtetëror përgjegjës me strukturat e tij është prej kohësh i ngritur dhe funksional.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.
- Shpjegoni arsyetimin tuaj.

16. Opsioni i rekomanduar/i preferuar është Opsioni 2, i cili do të sigurojë një bazë të re ligjore, që do të mundësojë realizimin e rolit rregullator të shtetit, në fushën e sigurisë së pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike.

Çështje të zbatimit

- Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.
- Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.
- Përkrahni masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.
- Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.

17. Hartimi i akteve nënligjore, të parashikuara në projektligj, do të bëjnë të mundur zbatimin e tij.

18. Për zbatimin e këtij projektligji, ngarkohen ministria përgjegjëse për energjinë elektrike, inspektoriati shtetëror përgjegjës për pajisjet, impiantet dhe instalimet elektrike, OMVK-të, si dhe të gjithë operatorët ekonomikë që kryejnë aktivitete që përfshijnë prodhimin, montimin, instalimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike.

Faza e shqyrtimit/vlerësimit

- Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.
- Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.

19. OMVK-të do të realizojnë vlerësimin e konformitetit të pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike.

20. Inspektoriati shtetëror përgjegjës, kryen inspektime periodike të operatorëve ekonomikë publikë dhe/ose privatë, që kanë në pronësi dhe/ose përdorim pajisje, impiante, instalime elektrike.

21. Pas hyrjes në fuqi të ligjit, ngarkohen Këshilli i Ministrave dhe ministri përgjegjës për energjinë elektrike, të miratojnë aktet nënligjore përkatëse për zbatimin e ligjit, që lidhen me kriteret që duhet të plotësojnë operatorët ekonomikë projektues të pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

Shënim: Në paragrafin më sipër, “Analiza e ndikimeve”, kemi cituar që implementimi i tij nuk ka kosto shtesë ekonomike apo financiare.

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës										
Kosto për buxhetin – një herë										
Kosto për buxhetin – në										

vazhdim										
Kosto për biznesin – një herë										
Kosto për biznesin – në vazhdim										
Kosto për grupet e tjera – një herë										
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto në total										
Kosto e zbritur në total = Kosto në total x faktorin zbritës										
Përfitimi për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi për biznesin – një herë										
Përfitimi për biznesin – në vazhdim										
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë										
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi në total										
Përfitimi i zbritur në total = Përfitimi në total x faktorin zbritës										
Vlera aktuale e koston në total										
Vlera aktuale e përfitimit në total										
Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e koston në total										

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1			
Opsioni 2			